



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 51.1 dhe 53.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, neneve 4, 9 dhe 10 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, dhe neneve 45.1 dhe 47.1 të Statutit të Komunës, nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 07 mars 2017, miratoi:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN E PËRBËRJES SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Neni 1

Ndryshohet përbërja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Podujevës, si vijon:

1. Shaban Osmani, LDK, anëtar
2. Sabri Hamiti, PDK, anëtar
3. Bahri Selimi, LVV, anëtar
4. Xhevdet Beselica, Grupi Plus, anëtar
5. Shaban Ahmeti, komuniteti ashkalinj, anëtar
6. Xhafer Ademi, komuniteti ashkalinj, anëtar
7. Valmire Lahu, komuniteti ashkalinj, anëtare
8. Mefail Rama, komuniteti rom, anëtar
9. Radisav Peroviq, komuniteti serb, anëtar

Neni 2

Komiteti për Komunitete, përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit dhe Rregulloren për përbërjen, kompetencat dhe rregullat e punës të Komiteteve dhe komisioneve të Kuvendit.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen Vendimi për themelimin e Komitetit për Komunitete nr.01-006-22994 i datës 13 mars 2014 dhe Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për themelimit e Komitetit për Komunitete, nr.01-020/40-6399117 i datës 2 shkurt 2017.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë, përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-020/04-17316/17
Podujevë,
07 mars 2017



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi